


Termit e Referencës

Për

**Ndërtimin e Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në
Parkun Kombëtar të Butrintit**



Maj 2026

Sfondi

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit (FMB) është themeluar nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë (MTKS) dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësim.

FMB vepron në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në mënyrë specifike qëllimi i saj është administrimi indirekt i nëzonalave të trashëgimisë kulturore, të Parkut Kombëtar të Butrintit, një pronë me vlerë universale, në përputhje me Ligjin Nr. 50/22 *“Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nëzonalave të Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”*.

Qëllimet e FMB-së janë të administrojë, ruajë dhe mbrojë asetet e trashëgimisë kulturore të Sitit të Trashëgimisë Botërore të Butrintit.

Në zbatim të Planit të Menaxhimit të Integruar 2020-2030, FMB hartoi Planin e Studimit të Trafikut dhe Menaxhimit të Vizitorëve në Parkun Kombëtar të Butrintit dhe të Shëndetit dhe Sigurisë. Qëllimi i këtyre planeve ishte të vleresonte opsione të ndryshme për të përmirësuar aksesin në zonë dhe menaxhimin e vizitorëve. Për këtë qëllim Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit hartoj projektin *“Platformat e Ngritura dhe Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”*.

Baza Ligjore

- Ligji 27/ 2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.
- Vendim nr. 1125, datë 30.12.2020 për *“Miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”*.
- Vendim nr. 1099, datë 24.12.2020 për *“Miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”*.
- Vendimi i KKTKM, Nr. 527, Datë 13.12. 2024 për *“Përbërjen e Manualit të Restaurimit, pikturën murale, drurin e dekoruar dhe mozaikun”*.

Zbatimi i punimeve duhet të respektojë parimet dhe standardet e përcaktuara në dokumentet ndërkombëtare, duke përfshirë:

- Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore (UNESCO, 1972).
- Kartën Ndërkombëtare për Konservimin dhe Restaurimin e Monumenteve dhe Siteve (Karta e Venecias, 1964).

- Kartën e ICOMOS për Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Trashëgimisë Arkeologjike (1990).

Përshkrimi i zonës së projektit

Parku Kombëtar i Butrintit përfaqëson një territor me vlera të jashtëzakonshme historike, arkeologjike dhe natyrore, i karakterizuar nga një ndërthurje komplekse e elementeve të trashëgimisë kulturore me ekosistemet natyrore. Territori paraqet një topografi të larmishme, me zona të ulëta të ndikuara nga prania e ujërave, terrene të pjerrëta dhe shtigje të zhvilluara historikisht mbi struktura arkeologjike të ndjeshme.

Në këto kushte, prioriteti kryesor i projektit është përmirësimi i aksesueshmërisë në të gjithë parkun, duke adresuar njëkohësisht problematikat që lidhen me sigurinë e vizitorëve dhe efektet e ndryshimeve klimatike, veçanërisht përmbytjet sezonale dhe degradimin e shtigjeve ekzistuese.

Aktualisht, aksesueshmëria në qytetin antik të Butrintit është e kufizuar për shkak të disa faktorëve kryesorë, si terreni i vështirë dhe i pabarabartë, mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për lëvizje të sigurt, si dhe mungesa e rampave dhe platformave të dedikuara për kategori të ndryshme përdoruesish. Këto kushte krijojnë vështirësi në lëvizje dhe rrisin riskun për aksidente, duke kufizuar ndjeshëm përvojën e vizitorëve dhe veçanërisht aksesin për personat me aftësi të kufizuara.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, garantimi i aksesueshmërisë në mjediset publike përbën një detyrim ligjor dhe funksional. Ky detyrim përfshin krijimin e infrastrukturës së përshtatshme, si rampa, shtigje të aksesueshme, sinjalistikë e qartë dhe elemente ndihmëse që mundësojnë pjesëmarrje të barabartë në jetën publike dhe sociale.

Në këtë kontekst, ndërhyrjet e propozuara synojnë jo vetëm eliminimin e barrierave fizike, por edhe përmirësimin e përgjithshëm të përvojës së vizitorëve, duke e bërë atë më gjithëpërfshirëse, të sigurt dhe të orientuar drejt përdorimit të qëndrueshëm të sitit.

Problematikat kryesore të identifikuar në terren përfshijnë praninë e sipërfaqeve të rrëshqitshme, ndryshime të papritura të nivelit, mungesë të elementeve mbrojtëse, si dhe zona të ekspozuara ndaj përmbytjeve sezonale. Këto problematika janë evidentuar në disa pika kyçe të itinerarit, përfshirë zonën e Teatrit, Forumin Romak dhe Gjinnazin, itinerarin pranë Portës së Liqenit, si dhe zonën midis Portës së Liqenit dhe Portës së Luanit.

Për shkak të ndjeshmërisë së lartë arkeologjike dhe mjedisore të këtyre zonave, çdo ndërhyrje kërkon një qasje të kujdesshme dhe të kontrolluar për mbrojtjen e integritetit të sitit.

Qëllimi dhe objektivat kryesorë

Qëllimi kryesor i këtij projekti është mbrojtja dhe ruajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Parkut Kombëtar të Butrintit, duke përmirësuar njëkohësisht aksesueshmërinë

dhe cilësinë e përvojës së vizitorëve, në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm dhe kërkesat për përfshirje sociale.

Ky qëllim synon të realizohet nëpërmjet ndërhyrjeve të kontrolluara infrastrukturore, të cilat adresojnë problematikat ekzistuese të aksesit dhe sigurisë, duke respektuar integritetin e sitit dhe duke garantuar përdorimin afatgjatë të tij pa dëmtime.

Në këtë kuadër, projekti ka për objektivat kryesorë si më poshtë:

1. Së pari, mbrojtja e sitit, duke siguruar ruajtjen e integritetit kulturor dhe natyror të Butrintit. Kjo përfshin reduktimin e rreziqeve të degradimit të shkaktuara nga përqendrimi i lartë i vizitorëve, përdorimi i pakontrolluar i shtigjeve ekzistuese dhe ndërhyrjet jo të përshtatshme në terren. Nëpërmjet organizimit të aksesit dhe orientimit të flukseve të vizitorëve, synohet minimizimi i presionit mbi zonat më të ndjeshme arkeologjike dhe promovimi i një përdorimi më të balancuar të territorit.

2. Së dyti, përmirësimi i cilësisë dhe qëndrueshmërisë së përvojës së vizitorëve, duke krijuar kushte më të sigurta dhe më të aksesueshme për të gjithë përdoruesit. Projekti synon të zhvillojë infrastrukturë të përshtatshme, si platforma të ngritura, rampa dhe shtigje të stabilizuara, të cilat mundësojnë lëvizje të sigurt dhe të kontrolluar, si dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë.

3. Së treti, rritja e sigurisë në sit, duke adresuar problematikat ekzistuese të lidhura me terrenin e rrëshqitshëm, ndryshimet e papritura të nivelit, mungesën e elementeve mbrojtëse dhe rrezikun nga përmytjet sezonale. Ndërhyrjet e parashikuara do të synojnë minimizimin e rreziqeve për aksidente dhe garantimin e standardeve të përshtatshme të sigurisë për vizitorët dhe personelin.

4. Së katërti, adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike, duke marrë në konsideratë ekspozimin e parkut ndaj fenomeneve si përmytjet, rritja e nivelit të ujërave dhe degradimi i shtigjeve. Projekti parashikon përdorimin e zgjidhjeve inxhinierike të përshtatshme, si platforma të ngritura dhe sisteme stabilizimi, të cilat mundësojnë funksionimin e vazhdueshëm të itinerareve edhe në kushte të pafavorshme klimatike.

Në tërësi, projekti synon të krijojë një balancë të qëndrueshme ndërmjet nevojës për akses dhe zhvillim të turizmit dhe detyrimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e një pasurie me vlerë të jashtëzakonshme universale.

Përshkrimi i ndërhyrjeve të parashikuara

Bazuar në rekomandimet e Planit të Trafikut dhe Menaxhimit të Vizitorëve, si dhe të Planit të Shëndetit dhe Sigurisë në Parkun Kombëtar të Butrintit, janë identifikuar zonat ku aksesueshmëria është e kufizuar ose paraqet rrezik për vizitorët, për shkak të terrenit të vështirë, përmytjeve sezonale dhe mungesës së infrastrukturës së përshtatshme.

Ndërhyrjet e mëposhtme përbëjnë një përmbledhje të kategorive kryesore të punimeve të parashikuara në projektin teknik të miratuar dhe duhet të realizohen në përputhje të plotë me vizatimet, specifikimet teknike dhe preventivin përkatës.

1. Platforma të ngritura për këmbësorë: Ndërtimi i platformave në zonat me përmbytje dhe terren të paqëndrueshëm, sipas projektit teknik.
2. Rampa për aksesueshmëri: Realizimi i rampave për lidhjen e niveleve dhe garantimin e aksesit për PAK.
3. Stabilizimi i shtigjeve ekzistuese: Sistemimi dhe përforcimi i shtigjeve sipas zgjidhjeve të projektit.
4. Nivelimi i sipërfaqeve të pabarabarta: Ndërhyrje për përmirësimin e vazhdimësisë së lëvizjes në zonat problematike.
5. Përmirësimi dhe përshtatja e shkallëve ekzistuese: Ndërhyrje për rritjen e sigurisë dhe funksionalitetit të shkallëve.
6. Vendosja e parapeteve dhe elementeve mbrojtëse: Instalimi i elementeve të sigurisë në zonat me risk, sipas projektit.

Kohëzgjatja e projektit

Kohëzgjatja e punimeve do të jetë sipas grafikut të punimeve të përfshirë në dokumentacionin teknik të tenderit.

Kontraktori duhet të respektojë afatet e përcaktuara dhe të paraqesë një plan të detajuar të organizimit të punimeve.

Kërkesat për Operatorët Ekonomikë

1. Kërkesa të përgjithshme për licencim

1.1 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë në ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale, si person juridik në zbatim, **në kategorinë N-Z/A/1 – “Zbatim në konservim dhe restaurim të rrënojave/siteve arkeologjike”**, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Kapaciteti teknik dhe profesional

Operatori Ekonomik duhet të disponojë kapacitetet e nevojshme teknike dhe profesionale për realizimin e plotë të punimeve, duke garantuar cilësinë, sigurinë dhe respektimin e kërkesave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

2.1 Stafi kryesor teknik

Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht stafin e mëposhtëm:

2.1.1 Drejtues teknik restaurimi

- I pajisur me licencë individuale restaurimi në kategorinë **Z/A/1**.
- Me përvojë në zbatimin e punimeve në site arkeologjike ose monumente kulture.
- Përgjegjës për drejtimin teknik të punimeve dhe zbatimin e projektit.

- Duhet të jetë i angazhuar dhe i pranishëm gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

2.1.2 Një Inxhinier ndërtimi të licencuar,

- I diplomuar në inxhinieri ndërtimi.
- Përgjegjës për aspektet konstruktive, organizimin teknik të zonave ku do të kryhen punimet dhe koordinimin e punimeve ndihmëse në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike.
- Me përvojë në punime infrastrukturore ose restauruese.

2.1.3 Një Arkitekt të licencuar,

- I diplomuar.
- Përgjegjës për dokumentacionin dhe raportimet gjatë zbatimit të projektit
- Me përvojë në punime infrastrukturore ose restauruese.

2.1.4 Specialist i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (HSE)

- I pajisur me certifikim përkatës.
- Përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planit të sigurisë në kantier.
- Monitoron respektimin e rregullave të sigurisë gjatë gjithë punimeve.

2.1.5 Arkeolog i licencuar

- I pajisur me licencë sipas kategorive përkatëse (A1/ A2/ A3 sipas legjislacionit në fuqi).
- Me përvojë në monitorimin e punimeve në site arkeologjike.

2.1.6 Teknik i mesëm ndërtimi për logjistikën e kantierëve.

2.2 Dokumentacioni për stafin

Për secilin prej anëtarëve të stafit duhet të paraqiten:

- Diploma përkatëse
- Curriculum Vitae (CV)
- Licencat dhe certifikimet përkatëse (aty ku aplikohet)
- Kontrata e punës ose marrëveshje bashkëpunimi

2.3 Kapaciteti në fuqi punëtore

Gjithashtu, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij jo më pak se 40 punëtorë të dedikuar për realizimin e këtij shërbimi.

3. Organizimi i punimeve

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një përshkrim të organizimit të punimeve, i cili duhet të përfshijë:

- Metodologjinë e realizimit të punimeve restauruese;
- Organizimin e kantierit;
- Planin e menaxhimit të sigurisë në punë;
- Masat për mbrojtjen e monumentit dhe të mjedisit përreth gjatë zbatimit të punimeve;
- Planin e sigurimit të cilësisë së materialeve.

Shëndeti dhe siguria:

I gjithë personeli i përfshirë në punime duhet të respektojë protokollet e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Këto përfshijnë:

- përdorimin e pajisjeve të mbrojtjes personale (PPE);
- respektimin e rregullave të sigurisë në kantier;
- sigurimin e zonës së punimeve për vizitorët;
- mbrojtjen e monumentit dhe të ambientit përreth gjatë ndërhyrjes.

Në përfundim të zbatimit të punimeve, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një plan të detajuar mirëmbajtjeje për të gjitha strukturat dhe materialet e implementuara, duke përcaktuar procedurat, frekuencën dhe masat e nevojshme për garantimin e funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së tyre.

Dokumentacioni i Tenderit:

Për marrjen e dokumentacionit të tenderit si më poshtë, dërgoni kërkesën tuaj në email-in tenders@bmf.al :

1. Projekt Zbatimi
2. Grafik Punimesh
3. Preventiv
4. Relacion Teknik
5. Specifikime Teknike

Komunikimi gjatë tenderit

Gjatë periudhës së tenderit komunikimi për pyetje do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën tenders@bmf.al